



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.103/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “eN Trade”, Rr “Agim Ramadani”, nr.78, Mitrovicë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Z.F., Drejtor i Zyrës për Shërbime juridike “Fetoshi Law”, SH.P.,K., adresa rruga “Ndue Perleshi” nr. 342, hyrja B kati I/15-1, Prishtinë, kundër të paditurës 1.Organi Shqyrtues i Prokurimit tutje (OSHP), me seli në Prishtinë, adresa rruga “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lubjanës, Kati i V-të, 2. Ministria e Shëndetësisë, me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit Nr. PSH.nr. nr.136/19 i datës 23.05.2019, anulimit të Njoftimit për anulimin e dhënies së kontratës i datës 13.03.2019 dhe njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit i datës 13.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publikë më datë 12.03.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Z.F., ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 11.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “eN Trade” me seli në Mitrovicë kundër të paditurit 1.Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, 2. Ministria e Shëndetësisë, me seli në Prishtinë PSH.nr. nr.136/19 i datës 23.05.2019, i të paditurës OSHP, me çka ka kërkuar që aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit të anulohet vendimi i të paditurës OSHP Nr. 136/19 i datës 23.05.2019, Njoftimi anulimin e dhënies së kontratës i datës 13.03.2019 dhe Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit i datës 13.03.2019, i të paditurës së dytë Ministria e Shëndetësisë të detyrohet e paditura e dytë të kompensoj dëmin material dhe fitimin e humbur me kamatë ligjore prej 8 %, në vlerën e vlerësimit të ekspertit financiar, **si e pa bazuar**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 14.06.2019, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi “eN Trade”, me seli Prishtinë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 1405/19, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. nr.136/19 i datës 23.05.2019, i të paditurës OSHP, me propozim që aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit të anulohet vendimi i të paditurës OSHP Nr. 136/19 i datës 23.05.2019, njoftimi anulimin e dhënies së kontratës i datës 13.03.2019 dhe njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit i datës 13.03.2019, detyrohet e paditura e dytë të kompensoj dëmin material dhe fitimin e humbur me kamatë ligjore prej 8 %, në vlerën e vlerësimit të ekspertit financiar.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 103/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit përgatitor më datë 16.10.2023, ndërsa mbajti seancë të shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 12.03.2024 kryesor publik me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat Z.F. sipas autorizimit të datës 27.05.2019, me pjesëmarrje të ekspertit Ilaz Popaj, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, andaj konform nenit 41 të LKA-së mungesa e palës të ftuar në mënyrë të rregullt nuk është arsye për shtyerjen e seancës.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se sa i përket vendimit të OSHP-së të kontestuar me nr.136/19 i datës 23.05.2019 është vendim i kundërligjshëm, subjektiv dhe i njëanshëm. Po

ashtu arsyetimi i vendimit ka mospërputhje të plotë me dispozitivin dhe kjo kuptohet shumë qartë ku tek arsyetimi konstatohet se Autoriteti Kontraktues, tutje (AK) Ministria e Shëndetësisë, tutje (MSH) i është shqiptuar gjobë për shkak të neglizhencës së tyre, me qëllim që të mos dëmtohet OE, kurse tek pika II e dispozitivit është vërtetuar njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit për LOT 2. Kompania “eN Trade” kishte ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit për LOT 2 në vlerën prej 134,310.96 Euro, ndërsa vlera e parashikuar nga MSH ishte 138,180.00 Euro, që domethënë se Kompania “En Trade” ka ofertuar brenda vlerës së parashikuar nga MSH.

5. Ka shtuar se në ankesën drejtuar OSHP-së i kanë bashkangjitur disa kuponë fiskal për të kuptuar dhe vërtetuar se çmimi i ofruar me prodhuesin galeika nuk është çmim më i lartë se çmimi i tregut. Tek NT Export-Ting Pharmaceutical G4, Ulpiana Mark dizdari D-Vi/6, Prishtinë çmimi është 50 cent një ampul 500mg e Vitaminës C, të barnatorja Dua Pharm, çmimi është 50 cent një ampul 500 mg e vitaminës C Galenika, kurse çmimi i ofruar është 0,486 euro, nuk është çmim më i lartë se i tregut, por është çmim i tregut. Procesi i prokurimit sipas legjislacionit primar dhe sekondar administrohet përmes të hapave, ndërsa hapi i dytë është parashikimi i vlerës së parashikuar, e që do të thotë se Ministria e Shëndetësisë në hapin e dytë ka parashikuar saktë vlerën e këtij tenderi, ndërsa krejt në fund në hapin e shtatë para nënshkrimit të kontratës thirret dhe i referohet se çmimet dhe vlera nuk është parashikuar saktë, ndërsa parashikimi i vlerës së kontratës nuk është hapi i fundit i një procesi të prokurimit. Vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit Këtë veprim e ka kryer AK konform nenit 13 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ, tutje (RrUOPP). Këtë fakt e dëshmon se vlera e parashikuar e kësaj kontrate ka qenë në kuadër të cimeve të tregut, sepse nuk mund të llogaritet se nuk është çmim i tregut nëse ofrohet një çmim për një produkt prej 50 cent, ndërsa nëse ky produkt në ndonjërin prej depove apo barnatoreve është 40 cent apo e kundërta, sepse kjo varet edhe prej prodhuesve të tjerë dhe përfaqësive që i kanë operatorët ekonomik.
6. Ka shtuar se kanë ofertuar me produktin e Acid Ascorbic sol për inj 500 mg /5ml me çmimin prej 0,486 euro, duke ofertuar brenda vlerës totale të parashikuar nga vet AK. Ofertimi i kompanive për këtë tender është bërë në muajin nëntor 2017 e ku në atë kohë vetë AK e ka parashikuar vlerën totale, ndërsa analiza e çmimeve të tregut është bërë një

vit më vonë në vitin 2018, prandaj nuk mund të bëhen krahasime të çmimeve një vite më vonë, e të merret vendimi për anulim për këto arsye kundërligjore. Ne këtë aktivitet është bere edhe njoftimi për dhënien e kontratës me datës 08.03.2018, ku brenda këtij njoftimi është parashikuar data e planifikuar e nënshkrimit te kontratës për datën 21.03.2018, por qe kontrata nuk është nënshkruar për shkak të ndërhyrjes se Ministrit ne atë kohe dhe kjo ndërhyrje është cekur edhe nga vete shkesat e AK-së konkretisht tek vendimi për refuzim te kërkesës për rishqyrtim te datës 20.03.2018. Sa për sqarim te gjykatës, kur OE En Trade ishte rekomanduar për kontratë kishte pasur një ankese ne OSHP nga kompania Liri Med ShPK, por qe me vendimin nr.113/18 te datës 07.05.2018 OSHP kishte lënë ne fuqi njoftimin për dhënien e kontratës për LOT 2 , dhe me këtë nënkuptohet se procedura e prokurimit për LOT 2 ka qene zhvilluar sipas legjislacionit ne fuqi dhe me këtë kuptohet se kompania En Trade ShPK me pastaj është diskriminuar ne kundërshtim me nenin 7 te LPK-se nga ana e AK, e poashtu edhe nga OSHP. Thjesht, OSHP me vendimin e saj të kundërligjshëm e ka dëmtuar materialisht kompaninë EN Trade dhe i ka pamundësuar nënshkrimin e kontratës dhe fitimin e humbur duke e lënë në fuqi njoftimin për anulim te AK. Në këtë rast veprimet kundërligjore te AK, dhe të vendimit të panelit shqyrtues i ka shpreh dhe ika bërë te qarte eksperti i OSHP-se S.B. me ekspertizën e tij te datës 10.04.2019 me nr.136/19 ku i njëjti e ka cekur dhe konstatuar se EN Trade ShPK i është mohuar nënshkrimi i kontratës ne mënyre te kundërligjshme.

7. Përfaqësuesi i paditësit konsideron se ligjërisht nuk lejohet te ndërhyhet ne proceset e prokurimit nga Ministri i cili kishte kërkuar qe të analizohen çmimet ofertuese në fazën para nënshkrimit të kontratës, sepse konform nenit 26 te LPK-se ishin përmbushur të gjitha kushtet për nënshkrim të kontratës. Për më tepër nuk është kompetence e komisioneve brenda institucioneve te analizoj çmimet referente dhe atë me një vit apo me tepër vonesë prej datës së ofertimit por kjo është përgjegjësi e Agjencionit të Statistikave të Kosovës. I propozon gjykatës ta aprovoj kërkesëpadisë si të bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës OSHP Nr. 136/19 i datës 23.05.2019, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i të paditurës së dytë Ministria e Shëndetësisë i datës 08.03.2018, detyrohet e paditura e dytë të kompensoj dëmin material dhe fitimin e humbur me kamatë ligjore prej 8 %, në vlerën e vlerësimit të ekspertit financiar.

Kundërshtimet e të paditurës

8. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi sipas parashtrësës së datës 29.05.2023, ka deklaruar se e kundërshtojnë padinë e paditësit paneli shqyrtues me rastin e vendimmarrjes bëri krahasueshmërinë e çmimeve të dhëna nga OE ankues dhe çmime që komisioni profesional i MSH ka marr nga tregu, andaj në bazë të këtyre dëshmime ka konstatuar se çmimet e ofruara nga OE ankues, janë dukshëm më ta larta se sa çmimet e tregut për produktet e njëjta. Duke u nisur nga ky fakt Paneli shqyrtues vlerëson se të aprovohet vendimi i AK-së, për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë nga fakti se nuk mund të dëmtohet buxheti i Republikës së Kosovës, duke rekomanduar për dhënie të kontratës OE që ka ofertuar me çmime dukshëm më të larta se çmimet e tregut, sepse një veprim i këtillë i AK-së do të ishte në kundërshtim me nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

9. Ka theksuar se paneli shqyrtues ka konstatuar se për mos formim të komisionit profesional për vlerësimin e çmimeve të tregut në fazën e vlerësimit të ofertave, por një veprim i tillë të ndërmarr nga AK MSH vetëm pas vendimit të OSHP-së PSH.nr. 113/18 të datës 07.05.2018, OSHP autoritetit kontraktues i shqiptoi gjobën në lartësinë e specifikuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Kjo gjobë AK-së i është shqiptuar për neglizhencën e tyre, nuk mund të dëmtohen OE-të pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit, ku ankuesin fillimit AK Ministria e Shëndetësisë e shpall si të përgjegjshëm pastaj këtë vendim-Njoftim për dhënie e vërteton edhe OSHP-ja.

10. Si përfundim ka theksuar se paneli shqyrtues vendimin e kundërshtuar e ka mbështet në nenin 104 par.4 të LPP-së pasi që ka marr për bazë pasojat e mundshme të dëmtimit të interesit publik dëmtimit të buxhetit, sepse në këtë aktivitet të prokurimit janë në pyetje burimet dhe fondet publike të cilat mund të dëmtohen jashtëzakonisht shumë me këto çmime të ofruara nga OE ankues. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit “En Trade” SH.P.K., dhe të vërtetohet si i ligjshëm Vendimi PSH.nr. 136/19 i datës 17.04.2019 i protokolluar më datë 23.05.2019.

Provat e administruara

11. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i OSHP me nr.PSH.136/19 i datës 17.04.2019, Njoftim nga komisioni për verifikimin e çmimeve të AK, me datë 27.11.2018, me prova të bashkangjitura, Njoftim nga komisioni për verifikimin e çmimeve të AK me datë 12.10.2018 me prova të bashkangjitura, Raport i ekspertit shqyrtues të prokurimit S.B. me nr.136/19 i datës 10.04.2019, Ankesë nga OE En Trade SHPK kundër AK, me datë 29.03.2019, Vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 20.03.2018, Kërkesë e datës 31.01.2019 nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore për divizionin e prokurimit MSH, Vendim mbi anulimin e prokurimit “Furnizimi me barna nga lista esenciale “LOT 2” (Acid Askorbik), Formular i dorëzimit të tenderit nga OE En Trade, Certifikata e regjistrimit të biznesit, Certifikata e autorizimit të marketingut, Certifikata e autorizimit të datës 08.11.2017, Vendim i PSH me nr.113/18 i datës 20.04.2018, Ekspertiza nga lëmia financiare e punuar nga eksperti I.P. me datë 10.02.2024, Shkresa e bashkangjitur parashtrësës të datës 08.12.2023: kërkesë për iniciimin e procedurës për kontraktim të barnave nga lista esenciale bashkangjitur deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, Poashtu paditësi ka parashtruar precizimin e kërkesëpadisë që ka të bëjë me shumën e kompensimit
12. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
13. Aktiviteti i Prokurimit është iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë me kërkesë për iniciimin e procedurës për kontraktim të barnave nga lista esenciale bashkangjitur deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, për të cilat ka skaduar kontrata duke i bashkangjitur listën e produkteve që duhet të kontaktohen dhe sasi të përkatëse të nxjerr nga planifikimi i institucioneve shëndetësore, si dhe çmimet referuese duke u bazuar nga kontrata e fundit, në mesin e barnave të përfshirë Acid

Ascorbic, doza 500 mg/5ml , sasia orientuese për 24 muaj 276,360.00 euro, çmimi 0.50, totali 138,180.00 euro.

14. OE “En Trade” SH.P.K, me Certifikatë të regjistrimit të biznesit, “eN Trade” SH.P.K., numri i regjistrimit të biznesit 71170942, data e regjistrimit 09.06.2015 ka dorëzuar Formularin e dorëzimit te tenderit nga titulli i kontratës “Furnizim me barna nga Lista Esenciale”, numri i prokurimit 206-17-4303-1-1-1, emri i produktit acid ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg/5ml, çmimi totali tenderit 134,310.96 euro, afati kohor i tenderit 90 ditë, nga data finale për dorëzim të tenderëve. “En Trade” SH.P.K., posedon Certifikata e autorizimit e datës 08.11.2017, me të cilën është i autorizuar që të marr pjesë në emër të “Galenika ad”, me seli në Serbi në emër të tenderit me titull “Furnizim me barna nga Lista Esenciale”, numri i prokurimit 206-17-4303-1-1-1, të ofroj produktin Acid Ascorbic forma sol për inj, doza 500 mg/5ml. Galeniken ad, me seli në Serbi është e pajisur me Certifikatë të autorizimit të marketingut nga Agjencia e Kosovës për produkte dhe pajisje medicinale për marketing të autorizuar. “En Trade” SH.P.K., fillimisht është rekomanduar për dhënie të kontratës për Lot 2. Ndaj këtij njoftimi ka parashtruar ankesë OE “Liri Med”Sh.P.K.

15. Me Vendimin i PSH me nr.113/18 i datës 20.04.2018, është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “Liri-Med” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale” për Lot 4,8,10,17,19,20, me numër të prokurimit 206/17/4303/111, i iniciuar nga AK Ministria e Shëndetësisë, dhe vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK Ministria e Shëndetësisë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale” për Lot 2,9 me numër të prok 206/17/4303/111, anulohet njoftimi për anulimin aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale” Lot 4,8,10,17,19,20 dhe lënda kthehet në rivlerësim për këto Lote. Lidhur me pretendimin e OE ankues "Liri Med" se operatorit te rekomanduar për kontratë "En Trade ShPK" për Lot 2, i ka skaduar vlefshmëria e tenderit, paneli shqyrtues ashtu siç e ka cekur edhe eksperti profesional, konstaton se me datën 01.03.2018 ky operator ekonomik përmes përfaqësuesit z. Nexhat Kabashi ka konfirmuar vazhdimin e afatit të vlefshmërisë edhe për 60 dite, pasi që me datën 28.02.2018 autoriteti kontraktues kishte kërkuar vazhdimin e vlefshmërisë së tenderit.

16. Pas vendimit të OSHP-së, dhe pas nënshkrimit të Kontratës nga Menaxheri i Prokurimit dhe Sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, për LOT 2, të nënshkruar nga paditësi en Trade SH.P.K., AK merr vendim për formimin e Komisionit për verifikimin e çmimeve.
17. Sipas Njoftimit nga komisioni për verifikimin e çmimeve te AK me datë 12.10.2018 me prova të bashkangjitura, Ministria e shëndetësisë ka njoftuar drejtorin e FSSH-së, për çmimet referente të siguruara në depot farmaceutike dhe barnatore për barnat nga lista esenciale, emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në depo 0.39 cent, Depo Phoe Farmaci-emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në njësi 0.25 cent, Depo Liri-Med- emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në njësi 0.60 cent, Depo Sinorg emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në njësi 0.32 cent, Barnatore Joni- emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në njësi 0.50 cent, Barnatore XH.R Dea- emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në njësi 0.30 cent, Barnatore emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në njësi 0.50 cent.
18. Sipas Njoftimit nga komisioni për verifikimin e çmimeve te AK, me datë 27.11.2018, me prova të bashkangjitura, Ministria e shëndetësisë ka njoftuar drejtorin e FSSH-së, për çmimet referente të siguruara në depot farmaceutike dhe barnatore për barnat nga lista esenciale, emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, çmimi mesatar i tregut në depo 0.25 cent, Depo ICN BM-emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, çmimi mesatar i tregut në depo 0.25 cent, Depo Nini Pharm-emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, çmimi mesatar i tregut në depo 0.28cent, Barnatore Arbri- emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, çmimi mesatar i tregut në njësi 0.50 cent njësi, Barnatore Valleriana emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, cmimi mesatar i tregut në njësi 0.050 cent, Barnatore Bashkimi- emri gjenerik Acid Ascorbic, forma sol për inj, doza 500 mg, çmimi mesatar i tregut në njësi 0.30 cent.

19. Nga Kërkesë e datës 31.01.2019 nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore për divizionin e prokurimit të MSH, Ministria e shëndetësisë- Fondi i Sigurimeve Shëndetësore i ka dërguar kërkesë Divizionit të prokurimit me arsyetim se në kohën e udhëheqjes së aktivitetit të prokurimit mund të mos jenë bërë analiza e çmimeve të tregut, rrjedhimisht edhe disponueshmërisë së fondeve dhe çmimi i kontratës është shumëfish më i lartë se çmimet referente në treg, duke propozuar që procesi të rikthehet në ri tenderim duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
20. Nga Vendim mbi anulimin e prokurimit “Furnizimi me barna nga lista esenciale “LOT 2” (Acid Askorbik), Ministria e shëndetësisë ka marr vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Furnizimi me barna nga lista esenciale “LOT 2” (Acid Askorbik), me arsyetim se është konstatuar se çmimi i produktit të ofruar nga OE është më i lartë se çmimet referente të tregut.
21. Nga Vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim e datës 20.03.2018, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtimin e OE “eN Trade”, SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna nga Lista Esenciale”, Lot 2 , me numër të prokurimit 206-17-4303-111 dhe numër të brendshëm 206-17-042-111, mbi njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të publikuar më datë 13.03.2019 në e-prokurim, dhe është vërtetuar njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me barna nga Lista Esenciale”, Lot 2 , me numër të prokurimit 206-17-4303-111 dhe numër të brendshëm 206-17-042-111, ndërsa Autoriteti Kontraktues-Ministria e Shëndetësisë pret ri tenderimin e aktivitetit të prokurimit, produktit Acid Ascorbic sol për inj, 500 mg/5ml.
22. OE “En Trade” SHPK ka parashtruar ankesë kundër AK, me datë 29.03.2019, kundër Ministrisë së Shëndetësisë, numri prokurimit 206-17-4303-111, sa i përket tenderit “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me nr. të prok 206-17-4303-111.
23. Në Raport ekspertit shqyrtues të prokurimit S.B. me nr.136/19 i datës 10.04.2019, i ka vlerësuar pretendimet në ankesë të pranueshme dhe ka konsideruar se lëshimi të cilat i ka bërë AK e ka diskriminuar OE ankues duke e privuar nga nënshkrimi i kontratës në lidhje me këto furnizime, duke pësuar kështu operatori ekonomik ofertues i shpallur

fitues përmes njoftimit për dhënie të kontratës dhe vërtetimit të vendimit të AK-së nga ana e vendimit të OSHP-së brenda vlerës së parashikuar të kontratës të planifikuar të AK-së. Ka rekomanduar që ankesa e OE “En Trade” SH.P.K., për tenderin e AK Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, aprovohen të bazuara dhe të njëjtin tender, rekomandon AK-në që ky aktiviteti i prokurimit të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, duke vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

24. Nga Vendimi i OSHP me nr.PSH.136/19 i datës 17.04.2019, nga Paneli Shqyrtues është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “eN trade”, SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111, i iniciuar nga AK Ministria e Shëndetësisë, vërtetohet vendimi i AK Ministria e Shëndetësisë Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111, nga AK Ministria e Shëndetësisë, i është shqiptuar gjobë AK- Ministrisë së Shëndetësisë në shumë prej 10,000.00 euro për mos hulumtim të çmimeve të tregut në fazën fillestare, por duke e marr një veprimet tilla vetëm pasi që OSHP-ja me vendimin PSH.nr. 113/18 t datës 07.05.2018, vërteton vendimin e AK-së, gjithashtu paneli shqyrtues edhe me vendime tjera ka vërtetuar se i njëjti AK nuk ka hulumtuar çmimet e tregut, në fazat e procedurës, siç parashihet em dispozitat e LPP-së, me arsyetim se sqaron se pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues, është se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe Vendimin i OSHP-se, Nr. 113/18 i datës: 07.05.2018. Lidhur me këtë pretendim, paneli shqyrtues konstaton se OE ankues "EN Trade" fillimisht ishte rekomanduar për kontrate për Lot 2, ndërsa pastaj kishte pasur ankese, mirëpo me vendimin e OSHP-se Nr.113/18 te datës 07.05.2018 ishte vërtetuar njoftimi për dhënie te kontratës për këtë lot. Duke u bazuar ne dëshmitë që i ka pasur ne dispozicion paneli shqyrtues, sqarojnë se kontrata ishte nënshkruar nga menaxheri i prokurimit dhe Zyrtari Kryesor Administrativ, mirëpo nuk ishte nënshkruar nga Ministri i Ministrisë se Shëndetësisë, me arsyetimin se duhet te formohen komisione për verifikimin e çmimit te ofruar nga ana e OE "eNTrade". Paneli shqyrtues sqaron se në fazën e nënshkrimit te kontratës nga menaxhmenti i larte i MSH-se formohet një komision profesional për hulumtimin e tregut për te vlerësuar se çmimet e ofruar nga operatori ekonomik ankues a janë sipas çmimeve te tregut apo jo. Paneli

shqyrtues me rastin e vendimmarrjes beri krahasueshmërine e çmimeve te dhëna nga OE ankues çmimeve që komisioni profesional i MSH ka marr nga tregu, andaj ne baze te këtyre dëshmime konstatoj se çmimet e ofruara nga OE ankues janë dukshëm me te larta se sa çmimet e tregut për produktet e njëjta. Andaj duke u nisur nga ky fakt paneli shqyrtues konstaton se aprovohet vendim i AK- për anulim te aktivitetit te prokurimit ne fjale nga fakti se nuk mund te dëmtohet buxheti i Republikës se Kosovës duke rekomanduar për dhënie te kontratës OE-n që ka ofertuar me çmime dukshëm me te larta se çmimet e tregut sepse një veprim i këtillë i AK-së do te ishte në kundërshtim me nenin 1 dhe 6 të LPP-së. Paneli shqyrtues konstaton se për mos formim te komisionit profesional për vlerësimin e çmimeve të tregut në fazën e vlerësimit te ofertave por një veprim te tille te ndërmarr nga AK MSH vetëm pas vendimit te OSHP-së PSH nr. 113/18 te datës: 07.05.2018, OSHP autoritetit kontraktues i shqiptohet gjobën ne lartësinë e specifikuar si në diapozitiv te këtij vendimi. Kjo gjobë AK-së i shqiptohet sepse për neglizhencën e tyre nuk mund te dëmtohen operatoret ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet te prokurimit, ku ankuesin fillimisht AK MSH e shpalle si te përgjegjshëm pastaj këtë vendimin -Njoftim për dhënie e vërteton edhe OSHP me vendimin lartcekur. Paneli shqyrtues duke pasur parasysh te gjitha rrethanat, faktet dhe dëshmitë që janë prezantuar nga palët në procedure, këtë vendim e mbështet ne nenin 104 paragrafi 4 te LPP-së, pasi që ka marr për bazë pasojat e mundshme te dëmtimit te interesit publik- dëmtimit te buxhetit sepse ne kite aktivitet te prokurimit, janë në pyetje burimet dhe fondet publike, te cilat mund te dëmtohen jashtëzakonisht shume me këto çmime te ofruara nga OE- ankues, kurse është e qartë nga te gjithë, se neni 1 i LPP-së qartëson ne mënyre eksplicite, se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejtë te shfrytëzimit te fondeve publike. Paneli shqyrtues duke u bazuar ne sqarimet e dhëna si me lart vërteton njoftimin për anulim te aktivitetit te prokurimit ne fjale duke i marr për baze te gjitha rrethanat dhe nenin 1 te LPP-se. Paneli shqyrtues konform nenit 117 te LPP-se, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si me lart vendosi si ne diapozitiv te këtij vendimi. Paditësi i pakënaqur ndaj vendimit ka iniciuar konflikt administrative në Gjykatë.

25. Nga Ekspertiza nga lëmia financiare e punuar nga eksperti I.P. me datë 10.02.2024, Eksperti I.P. ka konstatuar se fitimi i humbur i paditësit në rast se do të rekomandohej për kontrate për aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me barna nga lista esenciale

Lot 2 “, me numër të prokurimit 206-17-4303-111, iniciuar nga AK Ministria e shëndetësisë, është 67,984.56 euro.

Baza Ligjore

26. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP) Neni 6 paragrafi 1 parasheh se “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”, paragrafi 2 parasheh “Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës” Neni 7 përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, paragrafi 2 parasheh se “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”.
27. Neni 26 i LPP-së, përcakton nënshkrimin e kontratave publike, paragrafi 1 parasheh se “Përveç, siç përcaktohet në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni, zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Nënshkrimi dokumenton se kontrata është dhënë në pajtueshmëri me ligjin aktual”. Paragrafi përcakton: 2. Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe vërtetojnë se kontrata është në pajtim të plotë me këtë ligj. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme. 3. Nëse Ministri i financave e cakton AQP-në si organ përgjegjës për

kryerjen e një aktiviteti të prokurimit, personat e autorizuar për përmbylljen ose nënshkrimin e kontratës janë personat e përmendur në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni.

28. Neni 19 i LPP-së, rregullon Klasifikimin e Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar paragrafi 1. përcakton: “Kontratë me vlerë të madhe” konsiderohet me sa vijon: 1.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritët që të jetë e barabartë ose më e madhe se njëqind njëzet e pesë mijë (125.000) Euro;
29. Neni 59 paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, paragrafi 2 përcakton “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”, ... paragrafi 4 “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriteve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji”.
30. Neni 62 i LPP-së përcakton Përfundimin e Aktivitetit të Prokurimit paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit 1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 1.3. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është

bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontaktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit”. Neni 117 përcakton se “Afatit i fundit për marrjen e vendimeve 1. OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrin të tij”.

31. Sipas Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 44.6 procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Vlerësimi i gjykatës

32. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
33. Gjykata vlerëson se Autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë më datë 02.10.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111. AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderit ofertën e OE “eN Trade”, SH.P.K., e ka shpallur fituese për Lot 2 me çmim prej 134,310.96 euro. Me vendimin e OSHP-së PSH 113/18 të datës 07.05.2018 është vërtetuar njoftimi për dhënie të kontratës OE “eN Trade”,

SH.P.K. AK formon komision për vlerësimin e çmimeve të tregut, duke konstatuar se çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë janë shumë më të larta në krahasim me çmimet e tregut, ndërsa më datë 13.03.2019 AK Ministria e Shëndetësisë e anulon aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111. “eN Trade”, parashtroi ankesë më datë 29.03.2019 pranë OSHP-së, ndërsa eksperti shqyrtues i OSHP-së në ekspertizën nr. 136/19 të datës 10.04.2019, rekomandon që ankesa e OE “eN Trade”, të aprovohet si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për dhënie të kontratës. Më datë 23.05.2019 OSHP nxjerr vendim PSH.nr. 136/19 sipas të cilit aprovohet pjesërisht ankesa e “eN TRADE”, SH.P.K., dhe vërtetohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111 i inicuar nga AK Ministria e Shëndetësisë. Paneli shqyrtues, ka sqaruar se kontrata ishte nënshkruar nga Menaxheri i Prokurimit dhe Zyrtari Kryesor Administrativ, mirëpo nuk ishte nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë me arsyetimin se duhet të formohen komisione për verifikimin e çmimit të ofruar nga ana e OE "eN Trade". Konstaton se në fazën e nënshkrimit të kontratës nga Menaxhmenti i lartë i MSH-se formohet një komision profesional për hulumtimin e tregut për të vlerësuar se çmimet e ofruar nga operatori ekonomik ankues a janë sipas çmimeve të tregut apo jo. Paneli shqyrtues me rastin e vendimmarrjes krahasoj çmimeve të dhëna nga OE ankues çmimeve që komisioni profesional i MSH ka marr nga tregu, andaj në bazë të këtyre dëshmive ka konstatuar se çmimet e ofruara nga OE ankues janë dukshëm më të larta se sa çmimet e tregut për produktet e njëjta. Andaj aprovohet vendimi i AK- për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjale me arsyetim se OE-në ka ofertuar me çmime dukshëm më të larta se çmimet e tregut sepse një veprim i këtillë i AK-së do të ishte në kundërshtim me nenin 1 dhe 6 të LPP-së. Për mos formim të komisionit profesional për vlerësimin e çmimeve të tregut në fazën e vlerësimit të ofertave nga AK MSH por vetëm pas vendimit të OSHP-së PSH nr. 113/18 të datës: 07.05.2018, OSHP autoritetit kontraktues i shqiptohet gjobën në lartësinë e specifikuar si në diapozitiv të këtij vendimi. Vendimi i OSHP-së bazohet në nenin 104 paragrafi 4 të LPP-së, dhe neni 1 i LPP-së me qëllim që të sigurohet në mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

34. Gjykata vlerëson se Kompania “eN Trade” kishte ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit për LOT 2 në vlerën prej 134,310.96 Euro, ndërsa vlera e parashikuar nga MSH ishte 138,180.00 Euro. Pasi kontrata ishte nënshkruar nga Menaxheri i Prokurimit dhe Zyrtaari Kryesor Administrativ, para nënshkrimit të kontratës nga Ministri i Shëndetësisë, AK Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar sipas Kërkesës e datës 31.01.2019 nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore për divizionin e prokurimit të MSH, pas konstatimit se nuk është bërë analiza e çmimeve të tregut, rrjedhimisht edhe disponueshmërinë së fondeve dhe çmimi i kontratës është shumëfish më i lartë se çmimet referente në treg, Ministria e Shëndetësisë merr vendim për themelimin e Komisionit për verifikimin e çmimeve të ofertuara, bazuar në Neni 59 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së. Bazuar në Njoftimit nga komisioni për verifikimin e çmimeve të AK me datë 12.10.2018 dhe 27.11.2018 AK merr Vendim mbi anulimin e prokurimit “Furnizimi me barna nga lista esenciale “LOT 2” (Acid Askorbik), me arsyetim se është konstatuar se çmimi i produktit të ofruar nga OE është më i lartë se çmimet referente të tregut.
35. Gjykata vlerëson se konform Neni 26 i LPP-së, ku përcaktohet nënshkrimin e kontratave publike, nënshkrimi i Ministrit të Shëndetësisë është decidivisht i përcaktuar me dispozitat ligjore në Kontratave publike me vlerë të madhe, konform neni Neni 19 i LPP-së, ku rregullohet Klasifikimin e Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar paragrafi 1. përcakton: *“Kontratë me vlerë të madhe” konsiderohet me sa vijon: 1.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritet që të jetë e barabartë ose më e madhe se njëqind njëzet e pesë mijë (125.000) Euro, prandaj duke pasur parasysh se vlera e aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111. “eN Trade”, është 138,180.00 Euro, nënshkrimi i Ministrit të Shëndetësisë është i domosdoshëm dhe kontrata konsiderohet se është nënshkruar përfundimisht vetëm pas nënshkrimit të Ministrit, në përputhje me neni 19 të LPP-së, paragrafi 1 parasheh se *“Përveç, siç përcaktohet në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni, zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Nënshkrimi dokumenton se kontrata është dhënë në pajtueshmëri me ligjin aktual”*. Paragrafi përcakton: 2. Përveç nënshkrimit të zyrtarit*

përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe vërtetojnë se kontrata është në pajtim të plotë me këtë ligj. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme.

36. Prandaj në rastin konkret konsiderohet se Kontrata e Prokurimit për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111. e nënshkruar nga Menxheri i Prokurimit dhe Zyrtari i lartë Administrativ i AK, me paditësin “eN Trade” SH.P.K është e pazbatueshme pa nënshkrimin e Ministrit të Shëndetësisë, e që konfom po këtij Neni paragrafi 3. i njëjti është ligjërisht person i autorizuar për përmbylljen ose nënshkrimin e kontratës janë personat e përmendur në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni.

37. Andaj duke u nisur nga gjendja faktike e konstatuar Gjykata vlerëson se, Vendimi i OSHP me nr.PSH.136/19 i datës 17.04.2019, nga Paneli Shqyrtues me të cilën është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “eN trade”, SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111, i iniciuar nga AK Ministria e Shëndetësisë, vërtetohet vendimi i AK Ministria e Shëndetësisë Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me barna nga lista esenciale Lot 2”, me numër të prokurimit 206-17-4303-111, nga AK Ministria e Shëndetësisë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Për dështimin e AK për mos hulumtim të çmimeve të tregut në fazën fillestare, por duke e marr një veprimet tilla vetëm pasi që OSHP-ja me vendimin PSH.nr. 113/18 datës 074.05.2018, OSHP me të drejtë dhe bazuar në dispozitat ligjore i ka shqiptuar gjobë AK- Ministrisë së Shëndetësisë në shumë prej 10,000.00 euro.

38. Gjykata vlerëson se kontrata me vlerë të lartë nuk mund të përmbyllen pa verifikim të ofertave, përkundër dështimit të AK për ta themeluar Komisionit e verifikimit të çmimeve të tregut pas hapjes se ofertës, përmbyllja e procedurës së prokurimit,

respektivisht nënshkrimi i kontratës është përfundimisht në kompetencë të Ministrit dhe i njëjti nuk mund të detyrohet ta nënshkruaj kontratën me vlerë të lartë nëse AK ka bërë lëshime në procedurën e vlerësimit të ofertave. Prandaj Gjykata vlerëson se Vendimi i kundërshtuar i Paneli shqyrtues është i bazuar në nenin 1, 6, 26, 59, 60, 62 dhe nenin 104 paragrafi 4, 117 të LPP-së, me qëllim të sigurimit të mënyrën me efikase, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

39. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.103/22, datë 11.04.2024.

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.